



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rektori

Nr. 3632/Prot
1

Shkodër, më 22. 11 .2017

URDHER

nr. 327/, datë 22. 11 .2017

'Për disa ndryshime në urdhrin nr.327''

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 112, ligjin nr.10296, dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM-në nr. 866, datë 23.10.2015 "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2017-2018", VKM-së nr.269 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" vendimit të Bordit të Administrimit nr.64, dt.13.10.2017 "Për miratimin e tarifës së shkollimit për vitin akademik 2017-2018" urdhrin nr.327 datë 14.11.2017 "Për administrimin e procesit të mbledhjes dhe shqyrtimit të rasteve përjashtimore nga tarifa e shkollimit"

Urdhëroj

1. Të miratojë ndryshimet si më poshtë:
2. Pika 3 e urdhrin nr.327 ndryshohet "Kryesekretaria e Universitetit pranon gjithë aplikimet e studentëve për përjashtim/reduktin nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2017-2018, sipas afatit të parashikuar deri më datë 31.12.2017.
3. Pika 5 e urdhrin nr.327 ndryshohet "Kryesekretaria e pajisur me user-in për akses në portalin E – Albania, do të gjenerojë nga sistemi on-line certifikatat familjare apo personale të çdo aplikanti, pasi ky i fundit ka dhënë pëlqimin për administrimin e të dhënave personale (certifikata).
4. Pikat e tjera të urdhrin nr.327 datë 14.11.2017 mbetet në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Administratore e komanduar

Eriklida Shpori

Rektori

Prof.dr. Adem BEKTESHI

